



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 23, date 26/04/2004

**“PËR
PAJISJEN ME AUTORIZIM DEFINITIV PËR STREHIM TË NJË QYTETARI
ME BANIM NË RRUGËN “MYSLYM KETA”.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore “Për pajisjen me autorizim definitiv për strehim të një qytetari me banim në rrugën “Myslym Keta”, mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “e”, ligjin Nr.7652, dt.23/12/1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në VKM Nr.49, dt.29/01/1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”, në VKM Nr.530, dt.17/10/1994 “Për mënyrën e ndarjes së apartamenteve të ndërtuara nga Enti i Banësive”, e ndryshuar me Vendimin Nr.614, dt.05/12/1994, bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.156, dt.06/11/1998 “Për ndarjen në parim të apartamenteve të bllokut “Myslym Keta”, “Ali Visha”, “Riza Cuka”,

V E N D O S I;

I.Të pajiset me autorizim definitive qytetari i mëposhtëm i pastrehë:

1-Vjollca Asllan Shehu – P.2, Shk.3, Ap.29 me strukturë (3+1).

II.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, Enti Kombëtar i Banësive.

III.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI